



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit

	REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA RAHOVEÇ/OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC	
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET		
Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)		
Nr./Br./No <u>7569</u> Nr. i faq/Br.str/No.pg <u>59</u>		
Data/Datum/Date <u>29 / 06 / 26</u>		
RAHOVEC / ORAHOVAC		

PROCESVERBAL I TAKIMIT TË PARË PUBLIK TË KRYETARIT PËR PUNËN E TIJ NË GJASHTËMUJORIN E PARË TË VITIT 2026

PROCESVERBAL I TAKIMIT TË PARË PUBLIK TË KRYETARIT PËR PUNËN E TIJ NË GJASHTË (6) MUJORIN E PARË TË VITIT 2026

INFORMATË RRETH NJOFTIMIT

Me qëllim të ruajtjes së transparencës, rritjes së demokracisë në bazë të nenit 68, paragrafi 1 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, në bazë të neneve 23, 24 dhe 25 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017, nenit 7 të Rregullores Komunale për Transparencë NR.03/2019, kryetari i komunës së Rahovecit z. Smajl Latifi edhe në vitin 2026 ka vazhduar me takime publike, kështu duke rritur nivelin e bashkëpunimit me qytetarë.

Njoftimi për organizimin e takimit të parë publik për punën gjashtë (6) mujore të Kryetarit të Komunës së Rahovecit për vitin 2026, u publikua me datë: 5.6.2026 në ueb faqen e komunës së Rahovecit, në të dy gjuhët, në këtë vegëz: <https://rahovec.rks-gov.net/wp-content/uploads/2026/06/Njoftim-takimi-i-pare-publik-i-kryetarit-2026.pdf>

Njoftimi është publikuar edhe në facebook:

Njoftim: <https://www.facebook.com/share/p/19F83vTxXe/>



PROCESVERBAL I TAKIMIT TË PARË PUBLIK TË KRYETARIT PËR PUNËN E TIJ NË GJASHTË (6) MUJORIN E PARË TË VITIT 2026

TAKIMI PUBLIK

Takimi publik filloi në orën 10:00 më datë 19.6.2026 në Sallën e Kuvendit Komunal në Rahovec.

Të pranishëm në këtë takim ishin: Smajl Latifi, kryetar i komunës, drejtor të drejtorive, qytetarë, OJQ, fermer, drejtor të shkollave, kryetarë të fshatrave dhe lagjeve të qytetit të Rahovecit, zyrtarë komunal.

Blerta Gashi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm, i nderuar kryetar, nënkryetar, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunal, kryetarë të këshillave lokale dhe lagjeve urbane, drejtorë të shkollave, përfaqësues të shoqërisë civile, organizatave ndërkombëtare, përfaqësues të mediave, ju të pranishëm. Bazuar në obligimet ligjore që dalin nga Ligji për vetëqeverisje lokale dhe Rregullorja për transparencë në komuna, Kryetari i Komunës është i obliguar që të mbaj së paku dy takime publike me qytetarë. Takimi i parë publik duhet të mbahet në gjashtë mujorin e parë kurse takimi i dytë publik duhet të mbahet në gjashtë mujorin e dytë të vitit. Njoftimi për mbajtjen e takimit publik, ashtu siç prashihet në Udhëzimin administrativ për administrate të hapur në komuna, u publikua në të dy gjuhët më: 5 qershor 2026, 14 ditë para mbajtjes së takimit publik në web faqen zyrtare të komunës së Rahovecit, në Platformën qeveritare për konsultime publike si dhe në rrjetet sociale.

Janë njoftuar me kohë kryetarët e lagjeve dhe fshatrave, drejtorë të shkollave, përfaqësues të shoqërisë civile dhe përfaqësues të mediave.

Në këtë takim publik, në koordinim me kryetarin e komunës kemi caktuar një rend dite, si vijon:

- Raporti i kryetarit të komunës për periudhën janar-qershor të vitit 2026.
- Listën e aktiviteteve të evidentuara gjatë kësaj periudhe.

PROCESVERBAL I TAKIMIT TË PARË PUBLIK TË KRYETARIT PËR PUNËN E TIJ NË GJASHTË (6) MUJORIN E PARË TË VITIT 2026

Për takimin publik do të mbahet procesverbal, i cili do të përmbaj të gjitha informatat e dhëna nga përfaqësuesit komunal, propozimet e parashtruara nga publiku dhe reagimin ndaj tyre si dhe pyetjet dhe përgjigjet e dhëna, i cili do të publikohet ne web faqen zyrtare të Komunës.

Tani pa humbur kohë ftoj Kryetarin e Komunës ta bëj prezantimin e Raportit 6-mujor të punës si dhe Informatën rreth projekteve dhe aktiviteteve në komunën e Rahovecit.


Pas prezantimit nga kryetari i komunës, ju mund të shtroni pyetje dhe kërkesa për çështjet që ju interesojnë.

Smajl Latifi, kryetar i komunës së Rahovecit: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, bazuar në Planin e Punës së Kryetarit të Komunës dhe Qeverisë Komunale 2026, kemi kënaqesin të paraqesim para jush përmes videoprojektorit, raportin 6 mujor për punët, angazhimet dhe arritjet e komunës për periudhën janar-qershor 2026.

Të gjitha aktivitetet e zhvilluara gjatë gjashtë-mujorit 2026, janë të paraqitura në këtë raport ku ndërmjet tjerash, ju të nderuar kryetar të fshatrave dhe lagjeve të qytetit të Rahovecit, qytetarë të nderuar, keni mundësinë për t'u informuar më në hollësi përkritazi me çështjet e raportuara në këtë dokument.

Raporti në fjalë përfshinë punën e secilës drejtori, zyre dhe njësi organizative të Komunës. Përmbushja e objektivave dhe aktiviteteve është rezultat i punës ekipore të Qeverisë Komunale dhe shfrytëzoi rastin t'i shprehi mirënjohje të gjithëve për kontributin e dhënë dhe për rezultatet e arritura në zbatimin e planeve të punës.

Të nderuar qytetarë, kryetar të fshatrave dhe lagjeve të qytetit të Rahovecit, fermerë, OJQ, përfaqësues të bizneseve, drejtor të shkollave, për më gjerësisht mund t'i referoheni raportit në fjalë. Unë si kryetar i Komunës dhe drejtorët e Drejtorive të Administratës Komunale, jemi të gatshëm që t'iu përgjigjemi pyetjeve, komenteve dhe interesimeve tuaja për çdo çështje që janë të përmbledhura në këtë dokument.



PROCESVERBAL I TAKIMIT TË PARË PUBLIK TË KRYETARIT PËR PUNËN E TIJ NË GJASHTË (6) MUJORIN E PARË TË VITIT 2026

Raporti përmban pjesën hyrëse, prioritetet, zotimet, qellimet dhe synimeve që zakonisht janë standarde të cilat duhet ta përshkojnë çdo raport të kryetarit dhe të qeverisë sepse janë zotime publike dhe jemi të obliguar ti kemi pjesë të raportit. Raporti përmban edhe sfidat kryesore për vitin 2026. Realisht janë të evidencuara sfidat të cilat i ka komuna gjatë këtij gjashtëmuji.


Ne besojmë që raporti është objektiv dhe janë paraqitur në mënyrë të qartë aktivitetet, veprimet, sfidat, të arriturat, dobësitë në këtë gjashtëmuji, ne mirëpresim vërejtje, komente, propozime, ide dhe mund të përfshijmë në raport e që vijnë nga ky debat. Po ashtu falenderoj drejtoret e drejtoirë për gatishmerinë që Raporti të përgatitet me kohe, si dhe të publikohet në faqen zyrtare të komunes. Poashtu ne kemi edhe një informate ose listë të aktiviteteve të cilat pasqyrojnë punën e ekzekutivit për këtë 6 muji. Kemi paraqitur arritjet, sfidat, sukseset.

Ne pjesën e parë kemi një adresim për qytetarët, poashtu kemi edhe pjesën e skeletit të programit qeverisës për këtë vit, synimet tona për këtë vit.

Drejtoria e Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit raportoi për procedurat e zhvillimit urban, shqyrtimin dhe lëshimin e lejeve ndërtimore, trajtimin e kërkesave të qytetarëve, mbikëqyrjen e punimeve ndërtimore, hartimin e dokumenteve planifikuese dhe aktivitetet në mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu u raportua për përgatitjen e dokumenteve të planifikimit hapësinor dhe bashkëpunimin me institucionet përgjegjëse në realizimin e projekteve zhvillimore.

Drejtoria e Shërbimeve Publike prezantoi punën e realizuar në mirëmbajtjen e rrugëve lokale, ndriçimit publik, rrjetit të kanalizimit dhe ujësjellësit, pastrimin dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike, varrezave, parqeve dhe sipërfaqeve të gjelbra. U theksua angazhimi në eliminimin e deponive ilegale, përmirësimin e higjienës publike dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës komunale.

Drejtoria e Arsimit raportoi mbi organizimin e procesit mësimor, investimet në objektet shkollore, furnizimin e institucioneve arsimore me inventar dhe pajisje didaktike, mbështetjen e nxënësve dhe



PROCESVERBAL I TAKIMIT TË PARË PUBLIK TË KRYETARIT PËR PUNËN E TIJ NË GJASHTË (6) MUJORIN E PARË TË VITIT 2026

mësimdhënësve, realizimin e aktiviteteve edukative dhe përgatitjet për vitin e ri shkollor. U theksua bashkëpunimi i vazhdueshëm me drejtorët e shkollave dhe Këshillat Drejtues.

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale prezantoi aktivitetet në përmirësimin e shërbimeve shëndetësore primare, furnizimin me barna dhe material shpenzues, investimet në infrastrukturën shëndetësore, ofrimin e shërbimeve sociale për familjet në nevojë, mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara dhe realizimin e programeve sociale në bashkëpunim me institucionet përkatëse.

Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural raportoi për mbështetjen e fermerëve përmes subvencioneve komunale, shpërndarjes së inputeve bujqësore, realizimit të projekteve në sektorin e bujqësisë, mbrojtjes së kulturave bujqësore, zhvillimit rural dhe bashkëpunimit me donatorët dhe institucionet qendrore për rritjen e prodhimit vendor.


Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm prezantoi aktivitetet në mbështetje të zhvillimit ekonomik lokal, promovimit të investimeve, bashkëpunimit me bizneset, përgatitjes së projekteve zhvillimore dhe identifikimit të mundësive për financim nga fondet vendore dhe ndërkombëtare.

Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport raportoi mbi organizimin e aktiviteteve kulturore, mbështetjen e klubeve sportive, organizatave rinore dhe artistëve lokalë, mirëmbajtjen e objekteve sportive dhe kulturore, si dhe organizimin e manifestimeve tradicionale dhe ngjarjeve kulturore në komunë.

Drejtoria e Administratës prezantoi punën në ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët, përmirësimin e efikasitetit institucional, digjitalizimin e proceseve administrative, menaxhimin e burimeve njerëzore dhe ngritjen e transparencës në administratën komunale.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa raportoi mbi realizimin e buxhetit komunal, menaxhimin e financave publike, planifikimin e investimeve kapitale, pagesat ndaj operatorëve ekonomikë dhe respektimin e disiplinës fiskale.

Raportimi i zyrave komunale



PROCESVERBAL I TAKIMIT TË PARË PUBLIK TË KRYETARIT PËR PUNËN E TIJ NË GJASHTË (6) MUJORIN E PARË TË VITIT 2026

Gjatë prezantimit u raportua edhe për punën e zyrave komunale.

Zyra e Prokurimit realizoi procedurat e prokurimit publik për projektet komunale duke respektuar legjislacionin në fuqi dhe duke siguruar transparencë në proceset e kontraktimit.

Zyra Ligjore ofroi mbështetje juridike për organet komunale, përgatiti akte juridike, kontrata, vendime dhe përfaqësoi komunën në procedurat administrative dhe gjyqësore.


Zyra për Informim dhe Komunikim me Publikun vazhdoi informimin e rregullt të qytetarëve përmes komunikatave, konferencave, publikimeve në faqen zyrtare dhe rrjetet sociale, si dhe organizimin e konsultimeve dhe takimeve publike.

Zyra për Komunitete, Zyra për Barazi Gjinore, Njësia e Auditimit të Brendshëm, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe zyrat e tjera komunale raportuan mbi realizimin e kompetencave të tyre, me fokus në përfshirjen e komuniteteve, avancimin e barazisë gjinore, forcimin e kontrollit të brendshëm dhe ngritjen e kapaciteteve institucionale.

Ne kemi pasur disa arritje. Bie fjala, në fushën e shëndetësisë kemi pasur një zotim që për çdo lindje të realizuar në QKMF në Rahovec të ofrohet një mbështetje financiare. Kjo mbështetje fillimisht ka qenë 500 euro, ndërsa tani është rritur në 600 euro dhe, deri në fund të mandatit, synojmë ta rrisim në 750 euro.

Po ashtu, ne nuk kemi kapacitet për të realizuar një masterplan për sigurime shëndetësore. Megjithatë, brenda mundësive tona, shumë shpejt do të fillojmë me mbulimin e shpenzimeve të sigurimit shëndetësor për të gjithë fëmijët që ndjekin çerdhet publike. Ky do të jetë një shembull i mirë, të cilin besojmë se mund ta ndjekin edhe komunat e tjera. Rreth 400 fëmijë do ta gëzojnë këtë të drejtë dhe jemi komuna e parë që ndërmerr një hap të tillë.

Një sfidë tjetër me të cilën jemi përballur ka qenë ekzekutimi i mjeteve nga Thesari i Kosovës përmes procedurave përmbartimore lidhur me kontratën kolektive, gjë që ka ndikuar negativisht në realizimin e kontratave për projektet kapitale. Deri më tani, brenda gjashtë muajve, komunës i janë marrë rreth 4.5 milionë euro. Ndërkohë, buxheti ynë për investime kapitale është rreth 4 milionë euro. Mjetet janë tërhequr nga të gjitha kategoritë dhe kodet buxhetore.



PROCESVERBAL I TAKIMIT TË PARË PUBLIK TË KRYETARIT PËR PUNËN E TIJ NË GJASHTË (6) MUJORIN E PARË TË VITIT 2026


Edhe Komuna jonë, sikurse çdo komunë tjetër, nuk është nënshkruese e kontratës kolektive dhe, fatkeqësisht, po i bart pasojat financiare të zbatimit të saj. Përkundër faktit se ne jemi në favor të zbatimit të kontratës kolektive, meqenëse nuk jemi palë nënshkruese, kemi bërë presion të vazhdueshëm ndaj Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Financave që mjetet të mos tërhiqen nga buxheti i komunës. Megjithatë, ato vazhdojnë të merren nga buxheti ynë. Prandaj, vonesat në realizimin e disa projekteve duhet të shihen në funksion të këtyre pasojave financiare.

Një përmbledhje e pyetjeve të qytetarëve është dhënë në vijim. Të gjitha pyetjet iu përgjigjen, varësisht nga natyra e tyre, Kryetari i Komunës dhe drejtorët përkatës komunalë.

AFRIM LIMANI: Të nderuar pjesëmarrës! Më lejoni që në cilësinë e drejtorit për Buxhet dhe Financa t'ju shpjegojë buxhetin komunal për vitin 2027. Më datë 16 maj ka ardhur Qarkorja e Parë Buxhetore, që është dokument i rëndësishëm financiar i përcaktuar me Ligj të Financave Publike dhe Përgjegjësi dhe e përcakton hisen buxhetore për çdo komunë të Republikës së Kosovës. Sipas këtij dokumenti, buxheti i komunës së Rahovecit për vitin 2027 është 21.704.000€ dhe ndahet sipas programeve. Në administratë: 9.946.000 dhe kur e bëjmë një krahasim me vitin aktual, kemi rritje të buxhetit prej 778.000€. Në arsim: 634.305 dhe kur bëjmë krahasim me vitin 2026, kemi një zvogëlim prej 660.000. Në shëndetës: 2.323.000 dhe kur bëjmë krahasim me vitin aktual, kemi një rënie prej 36.000. E falënderoj ekipin tim të financave, që brenda një afati shumë të shkurtër kemi bërë një punë shumë intenzive. Në kategori ekonomike, përveç buxheti duhet të jetë kështu: Pozicioni i pagave: 12.919.000€, mallra dhe shërbime 2.821.000, shpenzime komunal 440.00, subvencione 1.000.000 dhe investime kapitale 4.523.000, 374.000 euro më pak në vitin 2027 se sa në vitin 2026. Të nderuar pjesëmarrës, si rezultat i kontratës kolektive jemi në një krizë financiare, krejt kjo si pasojë e kontratës kolektive, e cila deri më tani i ka tërhequr 3.5 milionë. Buxheti i arsimit gjithashtu ka ndikuar që ulje të buxhetit, sepse mungesa e nxënësve llogaritet sipas formulës. Drejtpërdrejt në zvogëlimin e buxhetit është edhe numri më i vogël i popullsisë, pra jemi 14.000 banorë më pak se sa në regjistrimin e parafundit.

Pyetjet dhe komentet e qytetarëve:

Pyetjet dhe komentet e qytetarëve



PROCESVERBAL I TAKIMIT TË PARË PUBLIK TË KRYETARIT PËR PUNËN E TIJ NË GJASHTË (6) MUJORIN E PARË TË VITIT 2026

Selman Shtavica, kryetar i HANDIKOS-it: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit dhe faleminderit, kryetar. Kam një pyetje për Drejtorinë e Arsimit. Në Komitetin për Persona me Aftësi të Kufizuara kam kërkuar që të formohet komisioni vlerësues për fëmijët me aftësi të kufizuara të nivelit parashkollor dhe për nxënësit e klasës së parë. Do të doja të di se në çfarë faze është kjo çështje.

Beatrisa Pista Demiri: Përshëndetje për të gjithë. Kam një kërkesë si banore e lagjes "**Dëshmorët e Pashtrikut**". Në cilën fazë janë punimet në këtë lagje dhe kur pritet të përfundojë rregullimi i kësaj rruge?

Murat Morina: Përshëndetje, kryetar, dhe gjithë ju të pranishëm. Kam një pyetje për drejtoreshën Nora Boshnjaku. Kemi probleme me KRU "Gjakova", e cila ndërhyr në rrugë, por punimet i lë të papërfunduara. Gjithashtu, kam një pyetje për drejtorin e Bujqësisë. E dimë se nuk ka mjete të mjaftueshme, por mendoj se nuk ka nevojë për kaq shumë promovim në Facebook dhe rrjetet sociale.

Muharrem Morina, Dejnë: Kam një pyetje për Drejtorinë e Shërbimeve Publike. A ekziston mundësia që projektet kapitale të dështojnë ose të mbeten të perealizuara si pasojë e tërheqjes së mjeteve nga buxheti i komunës?

Halit Sahitaj: Gjatë këtij viti kemi pasur vërshime, të cilat kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme. Për shkak të situatës është dashur të priset edhe një pjesë e hekurudhës. A ka mundësi të rregullohet përroi në fshatin Sarosh për të parandaluar dëme të ngjashme në të ardhmen?

Afrim Krasniqi, Pastasel: Përshëndetje. I kuptojmë vështirësitë që keni me buxhetin, por kam një kërkesë për rregullimin e rrugëve që lidhin Pastaselin me Baocin dhe Ratkocin. Po ashtu, kemi edhe disa kërkesa për rregullimin e rrugëve fushore. A ka ndonjë shpresë që këto projekte të realizohen?

Muhamet Morina: Përshëndetje të gjithëve. Sa i përket pyetjes lidhur me formimin e komisionit, ju njoftoj se menjëherë pas marrjes së detyrës kemi formuar komisionin vlerësues. Komisioni përbëhet nga pedagogu, psikologu, logopedi, një punëtor nga Qendra për Punë Sociale (QPS) dhe një mjek. Komisioni është funksional dhe deri më tani ka bërë vlerësimin e dy nxënësve. Kemi pranuar raportet për shkallën e dëmtimeve dhe tani duhet të angazhojmë asistentë për këta fëmijë me nevoja të veçanta. Shkollat duhet të parashtrajnë kërkesë në Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA), në bashkëpunim me prindërit.

PROCESVERBAL I TAKIMIT TË PARË PUBLIK TË KRYETARIT PËR PUNËN E TIJ NË GJASHTË (6) MUJORIN E PARË TË VITIT 2026

Nora Boshnjaku: Lidhur me pyetjen për KRU "Gjakova", gjendja në komunën tonë nuk është aq e mirë, por do të ishte mirë që të jeni më konkret për lokacionin ose rastin. Ne jemi të përkushtuar t'i zbatojmë kompetencat tona ligjore, përfshirë shqiptimin e gjobave ndaj KRU "Gjakova" në rastet kur nuk i përmbush obligimet e saj. Pas përfundimit të takimit mund të paraqisni një kërkesë të thjeshtë dhe ne jemi të gatshëm të dalim në terren për ta verifikuar gjendjen. Besoj se çështja mund të zgjidhet.

Përparim Krasniqi: Përsëritet. Ju njoftoj se punimet kanë filluar vitin e kaluar, mirëpo gjatë realizimit kemi hasur në dy probleme: rrjetin e kanalizimit atmosferik dhe fekal, si dhe ndërhyrjet e KRU "Gjakova", për shkak të amortizimit të gypave të asbestit. Megjithatë, javën e kaluar jemi njoftuar se tashmë janë krijuar kushtet për vazhdimin e punimeve.

Sa i përket kontratave, kemi dy mundësi. E para është që operatorët ekonomikë të pranojnë vazhdimin e kontratës me marrëveshje. E dyta është që, përmes amendamentimit të kontratës, realizimi i projektit të bartet për vitin e ardhshëm.

Smajl Latifi, kryetar i Komunës së Rahovecit: Mjetet e komunikimit janë të ndryshme dhe kanë një rëndësi të veçantë. Ne dëgjojmë shpesh zëra që thonë se po realizohen shumë punë, por ato nuk po publikohen sa duhet. Drejtori i Bujqësisë zhvillon shumë aktivitete, të cilat i publikon rregullisht, si dhe realizon vizita të vazhdueshme te fermerët në terren. Kjo është e mirëpritur nga fermerët, sepse përmes këtij komunikimi ne arrijmë të sensibilizojmë edhe më shumë qytetarët, institucionet qendrore dhe Ministrinë për nevojat dhe zhvillimet në sektorin e bujqësisë.

E përgëzoj drejtorin për angazhimin e tij dhe e inkurajoj që të vazhdojë të jetë edhe më aktiv. Besoj se ai nuk i zhvillon këto aktivitete për promovim personal, por sepse e konsideron detyrim institucional dhe e sheh të domosdoshme të jetë pranë qytetarëve dhe fermerëve.

Lajm i mirë është që ai do të vazhdojë t'i vizitojë fermerët në terren. Po aq e rëndësishme është që edhe drejtorët e tjerë të vazhdojnë të jenë në kontakt të vazhdueshëm me qytetarët. Ne e kemi obligim që të komunikojmë çdo ditë me ta, t'i dëgjojmë shqetësimet, kërkesat dhe hallet e tyre, në mënyrë që të ofrojmë zgjidhje sa më të mira dhe shërbime më cilësore për të gjithë.

Lajmin për mbajtjen e takimit publik mund ta gjeni të publikuar në vegëzën:

<https://www.facebook.com/share/p/1CfmwU1fLG/>

Takimi publik përfundoi në orën 11:20.

**PROCESVERBAL I TAKIMIT TË PARË PUBLIK TË KRYETARIT PËR PUNËN E TIJ
NË GJASHTË (6) MUJORIN E PARË TË VITIT 2026**

DËSHMI Nga Takimi i Parë Publik

